KLUBI I PRODHUESVE TË KOSOVËS
KOSOVO MANUFACTURING CLUB

RAPORT I PUNËS

2019

- Avokim për përmirësim të politikave
- Bashkëpunim në mes të prodhuesve vendor & grupeve të interesit
- Vetëdijësim dhe promovim i produkteve “Made in Kosova”

PËRMBAJTJA

Hyrje	4
Këshilli mbikqyrës	5
Rreth nesh	6
4E	7
Anëtarët	8
Fuqia e Klubit të Prodhuesve të Kosovës	8
Angazhim për të avancuar zhvillimin ekonomik	9
Fuqia e të qenurit aktiv	9
Fokusi digjital	10
Projektet	11
Programi për trajnimin në punë	12
Festivali i Gjelbër, Edicioni i 4-të	14
Platforma "Made in Kosova"	15
Punëtoria "Made in Kosova"	16
MEPPS	17
KOCME	18
Aktivitetet	19
Vizitat e punës jashtë vendit	21
Pjesëmarrja në konferencat rajonale	22
Mirënjohjet për punën e Klubit	23
Përkujtim	24
Ekipi i Klubit të Prodhuesve të Kosovës	26

Hyrje

Të nderuar,
Ka qenë nderi dhe privilegji im të jem kryetari i Klubit të Prodhuesve përgjatë vitit 2019. Viti 2019, ishte një vit me shumë angazhime dhe me punën tonë kemi arritur të jemi të suksesshëm. Si kryetari Klubit të Prodhuesve jam angazhuar maksimalisht që projektet dhe aktivitet e Klubit të jenë në përputhje me vetë qëllimet dhe synimet tona.

Edhe këtë vit Klubi i Prodhuesve si bazë të funksionimit të tij ka pasur strategjinë kryesore të Klubit, strategjinë 4E (Energy, EconomicDiplomacy,Employment, Environment) e cila përfshinë Energjinë, Diplomacinë ekonomike, Punësimin dhe Ambientin. Të gjitha projektet dhe aktivitete e Klubit të Prodhuesve edhe këtë vit janë zhvilluar në bazë të kësaj strategjie.

Përgjatë këtij viti jemi përpjekur që të mundësojmë rrjetëzimin e anëtarëve të vetë Klubit, por edhe prodhuesve tjerë. Kemi qenë urë lidhëse dhe kemi ndihmuar bashkëpunimin në mes tyre, por edhe me institucionet shtetërore dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare në vendin tonë.

Me punën e përbashkët të gjithë prodhuesve ne jemi munduar të ndihmojmë ekonominë e vendit tonë. Por para së gjithash, jemi munduar të ua lehtësojmë dhe përmirësojmë jetën qytetarëve tanë, duke krijuar vende të reja të punës por edhe duke investuar në prodhimin e vendit.

Ne jemi të vetëdijshëm që jemi treg i vogël dhe me vite kemi hasur në shumë pengesa, ku me shumë mund dhe sakrifica kemi arritur që këto vite të zhvillojmë dhe të forcojmë sektorin e prodhimit. Por, nëse punojmë dhe veprojmë bashkë, atëherë gjithsesi do të jemi të fuqishëm por edhe tejet interesant dhe tërheqës për investitorët e mëdhenj.

Puna jonë e përbashkët për të përmirësuar mjedisin e të bërit biznesit, organizimi i ngjarjeve të rëndësishme ka bërë që ndikimi dhe puna e Klubit të Prodhuesve të rritet. Këtë vit kemi pasur kënaqësinë që të mirëpresim 3 anëtarë të rinj, kompani prodhuese shumë të suksesshme në vendin tonë. Ku jemi krenarë që jemi pjesë e një familje dhe i falënderojmë për besimin dhe përkushtimin që të jenë pjesë e Klubit.

Unë jam veçanërisht krenar për punën e këshillit ekzekutiv të Klubit të Prodhuesve, me përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar gjatë këtij viti. Sigurisht punë kjo që do të vazhdojë edhe në të ardhmen.
Për fund, Klubi i Prodhuesve edhe në vitet në vazhdim do të mbështesë zhvillimin ekonomik të Kosovës, sepse vetëm një Kosovë e qëndrueshme dhe e zhvilluar ekonomikisht do të jetë në gjendje të promovojë stabilitet dhe prosperitet për vendin.

Sinqerisht,

Kryetar i Klubit të Prodhuesve të Kosovës

Fejzulla Mustafa

Këshilli mbikqyrës

Këshilli Mbikëqyrës kontrollon implementimin e qëllimeve të Klubit dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të parapara në statut dhe në planin strategjik dhe njëkohësisht është përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së zyrtarëve dhe nëpunësve si dhe për kontrollimin e raporteve financiare të Klubit.

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga:

Visar Kelmendi

Rreth nesh

Klubi i prodhuesve të Kosovës (KPK) është organizatë jo qeveritare e themeluar në Nëntor të vitit 2015 me **tre objektiva themelore: të avokoj për ndryshime në politika** duke përfaqësuar prodhuesit vendor, **të rrisë bashkëpunimin mes prodhuesve vendor dhe grupeve të interesitsi dhe të ngrit vetëdijen e qytetarëve** për rëndësinë e konsumit të prodhimeve vendore dhe **të promovoj produktet "Made in Kosova"**.

Anëtarët e KPK-së janë **kompani prodhuese që përfaqësojnë sektorë të ndryshëm** nga tregu i Kosovës. Fokusi kryesor i KPK-së është avokimi për ndryshimet e politikave në të mirë të prodhuesve vendor duke gjetur informacione të argumentuara të cilat u drejtohen institucioneve përkatëse.

Misioni i KPK-së është që kompanitë prodhuesve kosovare të bëhen më **konkurruese** dhe të **adaptueshme** në ekonominë globale dinamike.

Një element tjetër i rëndësishëm i aktiviteteve tona është promovimi i prodhimeve vendore 'Made in Kosova', ku organizata jonë luan rol të rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes së konsumatorëve kosovarë për benefitet që vinë nga konsumi i prodhimeve vendore.

Aktivitetet kryesore të Klubit të Prodhuesve të Kosovës fokusohen rreth **strategjisë** kryesore të Klubit e emëruar **4E (Energy, Economic Diplomacy Employment, Environment)** e cila përfshinë Energjinë, Diplomacinë ekonomike, Punësimin dhe Ambientin.

4E
ENERGY
EMPLOYMENT
ECONOMIC DIPLOMACY
ENVIRONMENT

4E ENVIRONMENT

Ambienti

Klubi i Prodhuesve të Kosovës në kuadër të Strategjisë së Ambientit dëshiron të ndërtojë zhvillim të qëndrueshëm të sektorit ekonomik i cili respekton dhe kujdeset për ambientin. Suksesi i kësaj strategjie varet nga përpjekjet e kombinuara të grupeve të shumta të ruajtjes dhe qëndrueshmërisë në vend, bizneseve dhe organizatave të tjera qeveritare dhe joqeveritare. Synimi i Strategjisë është të mbështesë, të plotësojë dhe të nxisë këto përpjekje

4E ENERGY

Energjia

Strategjia e Energjisë e KPK-së – adreson potencialet dhe sfidat që ka sektori i prodhimit sa i përket energjisë. Përmes kësaj strategjie synohet të bashkëpunohet me prodhuesit që të rrisin produktivitetin e tyre duke zbatuar masat e efikasitetit energjetik. Po ashtu, inkurajon prodhuesit që të përdorin energjinë e ripërtëritshme dhe efiçiente si pjesë të zhvillimit të përgjithshëm të qëndrueshëm të vendit.

4E EMPLOYMENT

Punësimi

Strategjia e Punësimit e Klubit të Prodhuesve të Kosovës synon që në koordinim me partnerët relevant tëpërmirësojësistemin e arsimit e formimitprofesional. Ku pjesë e rëndësishme e këtij sistemi do të jetë dhe ndërtimi I një partneriteti të qëndrueshëm me të gjithë akterët e tregut të punës. Kështu duke u fokusuar në krijimin e profesioneve të cilat janë të përshtatshme për tregun e punës dhe njëkohësisht duke kontribuar në zvogëlimin e hendekut të aftësimit professional në sektorin e prodhimit.

4E ECONOMIC DIPLOMACY

Diplomacia ekonomike

Strategjia e Diplomacisë Ekonomike e Klubit Prodhues të Kosovës synon të nxisë rritjen e sektorit të prodhimit në vend. Kjo strategji synon, në bashkëpunim me palët e interesuara, të përdorin të gjitha lidhjet diplomatike për të përparuar prosperitetin e produkteve Made-in-Kosova jashtë tregjeve të vendit. Diplomacia ekonomike është një nga çelësat më të rëndësishëm për produktivitet më të lartë dhe zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

Anëtarët

Klubi ka gjithsej **21 anëtarë**, të cilët posedojnë **45 fabrika**, dhe janë akterëkyç në punësimin e të rinjve duke punësuar kështu më shumë se **15 mijë punëtorë** direkt dhe indirekt në të gjithë vendin.

Anëtarët e Klubit vijnë nga sektorë të ndryshëm të prodhimit në Kosovë siç janë: sektori i ushqimit, ndërtimit, përpunimit të metalit, përpunimit të drurit, riciklimit dhe paketimit. Ata kanë zhvilluar deri më tash më shumë se **100 brende** dhe janë në zhvillim të produkteve dhe brendeve të reja.
Anëtarët e KPK-së kanë investuar mbi **90 milionë euro** në ekonominë e Kosovës vetëm në dy vitet e fundit.

Fuqia e Klubit të Prodhuesve të Kosovës

21 Anëtarë

15k Të punësuar direkt dhe indirekt nga anëtarët e Klubit të Prodhuesve të Kosovës

45 Fabrika në pronësi të anëtarëve të Klubit të Prodhuesve të Kosovës

100 Brende dhe produkte

Angazhim për të avancuar zhvillimin e sektorit të prodhimit

KPKpërgjatë vitit 2019 ka punuar në vazhdimësi për të avancuar zhvillimin e sektorit të prodhimit në Kosovë.

Fuqia e të qenurit aktiv

- Mbi 200 **kontakte** të zyrtarëve të **nivelit të lartë**
- Janë pritur **12 delegacione** nga insitucionet ndërkombëtare dhe bashkëpunëtorë
- **150 lidhje** të reja
- Janë nënshkruar **8 memorandume bashkëpunimi** me institucione dhe bashkëpunëtorë
- 10+ ngjarje të **suksseshme**
- 6000+ pjesëmarrës të **kënaqur**
- **15 propozime** për politika ekonomike
- Janë analizuar dhe komentuar një sërë **projekt-aktesh ligjore**
- Janë hartuar **10+ kërkesa** për Institucione shtetërore

- 8 raporte të **analizave ekonomike** dhe **sektoriale**
- 3 Raporte **studimore**
- **4 hulumtime** me konsumatorë
- **4 ni ma** të lansuara
- Mbi **600 takime** të zhvilluara
- **30+ komunikata**, të cilat janë ndarë me mediat vendore
- Mbi **170 shpërndarje** të komunikatave
- **27 paraqitjet mediale** ku Klubi është prezantuar
- Monitorimi i medieve, **70+ përmbledhje** me ngjarjet në ekonominë vendore
- **150,000+** Email-a të shkëmbyera
- **1,500+** Përmendje mediale

Fokusi digjital

Fokusi i KPK-së ka qenë dhe do të vazhdoj të jetë përcjellja e mesazhit të duhur në kohën dhe vendin e duhur.
Kjo është arsyeja pse ne, Klubi përdorim të gjitha mjetet dhe rrjetet për t'i mbajtur ndjekësit dhe të gjithë akterët tjerë të informuar/përditësuar.

Klubi i Prodhuesve në @WWW
www.klubiprodhuesve.org

11,146+ njerëz e kanë vizituar webfaqen e Klubit të Prodhuesve
4,058+ prej tyre kanë qenë përdorues të rinj.
88% kanë qenë vizitorë të rinj dhe 12% kanë qenë vizitorë që janë rikthyer ta vizitojnë faqen.

Klubi i Prodhuesve në @Twitter
@KlubiProdhuesve

Më shumë se 200 tweets kanë arritur 150 ndjekësit tanë.
Tweets e Klubit kanë fituar mbi 10,183 përshtypje përgjatë vitit 2019, që mesatarisht ka pasur rreth 30 përshtypje në ditë.

Klubi i Prodhuesve në @YouTube
@KlubiProdhuesvetëKosovës

Videot e KPK-së kanë pasur 11,300 përshtypje/impressions me 773 shikime.
Videot e ndara në kanalin e YouTube janë video nga aktivitet dhe programet e Klubit të zhvilluara gjatë vitit.

Klubi i Prodhuesve të Kosovës në @Facebook
@klubiprodhuesve.org

Klubi i Prodhuesve të Kosovës në @ Facebook
@klubiprodhuesve.org
Prej Janarit 2019, faqja në Facebook e KPK-së ka pasur një rritje të qëndrueshme të ndjekësve nga 2151 pëlqime në faqe në 3440 pëlqime, duke arritur 235,064 përdorues në Facebook. Ndërsa, faqja e Klubit ka pasur mbi 400,676 përshtypje përgjatë tërë vitit.

Klubi i Prodhuesve të Kosovës @e-mail
info@klubiprodhuesve.org

Përgjatë, vitit 2019 KPK ka dërguar mbi 20 email/kampanja përmes platformës MailChimp, për informim rreth aktiviteteve dhe projekteve te Klubit. Po ashtu, gjatë këtij viti është bërë edhe buletini i Klubit të Prodhuesve në baza mujore, të cilin e dërgojmë në formë të E-Lajmeve nga Klubi.

Projektet

Aktivitetet kryesore të KPK-së fokusohen rreth strategjisë kryesore të Klubit e emëruar 4E (Energy, Economic Diplomacy Employment, Environment), e cila përfshinë Energjinë, Diplomacinë ekonomike, Punësimin dhe Ambientin.

Të gjitha projektet e KPK-së edhe këtë vit janë zhvilluar në bazë të kësaj strategjie.Gjatë vitit 2019 janët realizuar këto5 projekte,ndërsa 1 projekt i fundit i listuar në vijim është në fazën fillestare të implementimit:

- Programi për trajnimin në punë;
- Festivali i Gjelbër, edicioni i katërt;
- Platforma "Made in Kosova";
- Punëtoria "Made in Kosova";
- MEPPS – Skema e Planifikimit dhe Promovimit të Eksportit për Prodhuesit (Manufacturing Export Promotion Plan Scheme);
- KOCME – Qendra Kosovare për Përsosmëri të Prodhimit (Kosovar Center for Manufacturing Excellence).



Programi për trajnimin në punë

KPK ka implementuar me sukses projektin “Programi për Trajnimin në Punë”, projekt ky i cili mbështetet financiarisht nga projekti i USAID, EMPOWER Sektori Privat, në partneritet me Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar-Sida.

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi është promovimi i përfshirjes sociale i të rinjve të margjinalizuar dhe të papunësuar nëpërmjet sigurimit të mbështetjes për përfshirjen e tyre në tregun e punës. Ky program implementohet nga Klubi i Prodhuesve dhe mbështet nga USAID EMPOWER Sektori Privat, në partneritet me Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA).

Përmes këtij programi Klubi synon të zhvillojmë një qasje të bazuar në nevojat e të rinjve të margjinalizuar për të hyrë në tregun e punës. Qëllimi është të krijohet një qasje sistematike për të mësuarit në vendin e punës, duke përafruar strategjitë e mësimit me vendin e punës bazuar në një plan program, por njëkohësisht duke inkurajuar edhe punëdhënësin, politikë bërësit, si dhe pjesëmarrjen e mësimdhënësve.

Si pjesë e implementit janë përgatitur materiale trajnuese dhe dokumentacion ligjor për secilën kompani pjesëmarrëse në këtë projekt dhe si pjesë e aktiviteteve KPK ka organizuar një seri punëtorish për të trajnuar stafin e kompanive për procedurën e marrjes në punë, aspektet ligjore, përgatitjen e trajnimit teknik dhe trajtimin e praktikantëve. Për të siguruar vazhdimësinë dhe ndërtimin e kapaciteteve, janë prodhuar manuale, prezantime, udhëzime dhe materiale të tjera për përfitimin e kompanive pjesëmarrëse.

- Projekti është implementuar në Komunën e Kaçanikut, Han i Elezit, Vitisë dhe Gjilanit
- **15 Muaj** kohëzgjatja e projektit
- **15 Sesione** informuese
- Janë mbajtur **25 punëtori** për kompnitë pjesëmarrëse në këtë projekt
- Janë pranuar dhe proceduar mbi **2000 aplikacione** për trajnim në punë prej të rinjëve
- Mbi **1000 intervista** të mbajtura
- **25+ Kompani** prodhuese pjesëmarrëse.
- **100+ Vizita** në kompani prodhuese pjesëmarrëse
- **250+ të rinjë** kanë përfunduar programin e praktikës
- **130+ të rinjë** të punësuar (targeti ishte 50 të punësuar)

Festivali i Gjelbër, Edicioni i Katërt

Festivali i Gjelbër është i **vetmi panair** në Kosovë, që si synim kryesor ka promovimin e biznesit të gjelbër. Ky ishte viti i katërt që u organizua dhe ku kompanitë e sektorit të gjelbër u mblodhen për të ndarë praktikat e qëndrueshme mjedisore që korrespondojnë me qëllimet globale për një ambient sa më ekologjik. Festivali synon të promovojë bizneset e gjelbra (përfshirë edhe sektorin e ndërtimit) në Kosovë, gjenerim të vendeve të punës të vazhdueshëm, të nxisë përmirësimet e nevojshme ligjore për mjedisin e biznesit të gjelbër dhe të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për përfitimet e adoptimit të praktikave/ teknologjive të gjelbra.

Edicioni i katërt i **Festivalit të Gjelbër** u organizua me **sukses** duke u rritur sa i përket numrit dhe cilësisë së ekspozuesve me **23.6% rritje** dhe arriti **vizitueshmërinë rekorde** nga të gjitha edicionet e deri tanishme. Aktivitetet kryesore ishin **Pavilioni i Gjelbër, Forumet e Gjelbra dhe aktivitetet paralele**. Suksesin e arritur, do të i'a lejojmë të dhënave të mëposhtme ta tregojnë:

- **47 Kompani** pjesëmarrëse
- **2,900 vizitorë** (6630 vizitorë "Kumulativ")
- **9 Forume** me 260+ pjesëmarrës
- **4 prezantime** produkteve
- **2 punëtori** me 110+ pjesëmarrës
- **675+** Kontakte të vlefshme
- **1,205,900€** shitje potenciale
- **11+ Kontrata** bashkëpunimi
- **12+ mediume** prezente vetëm në **ceremoninë hapëse.**

Platforma "Made in Kosova"

Platforma "Made in Kosova" është platforma e vetme në Kosovë, e cila do të prezantoj të gjitha kompanitë prodhuese të Kosovës. Qëllimi kryesor i Platformës është **dixhitalizimi i bizneseve prodhuese të Kosovës** me qëllim të **promovimit të produkteve kosovare në mbarë botën.** Platforma është një panair i përhershëm online, ku secila kompani ka profilin e vet të kompanisë si dhe prezantohen produktet e saj. Platforma "Made in Kosova" do të vendosë produktet tona në hartën e produkteve të botës, do të i'u shërbejë rritjes dhe zhvillimit të kompanive kosovare, veçanërisht kompanive të vogla dhe të mesme, do të rris punësimin në Kosovë dhe do të i'u mundësojë kompanive të mëdha të bëhen pjesë e zinxhirit të vlerave globale.

Aktualisht, në platformë janë të prezantuara kompanitë më të mëdha eksportuese kosovare. Platforma synon të prezantoj rreth 3,000 kompani me rreth 30,000 produkte dhe në vazhdimësi është duke u zhvilluar tutje për të qenë në hap dhe në nivel me platformat e ngjashme botërore. Platforma tanimë është lider në Kosovë sa i përket prezantimit online të kompanive prodhuese dhe produkteve kosovare dhe brenda një periudhe disa mujore ka arritur të ketë:

- **Mbi 55,000** vizitorë
- Dhjetëra kërkesa për **eksport** të produkteve kosovare;
- Interesim për krijim të **ndërmarrjeve bashkëpunuese** në mes të blerësve të huaj dhe kompanive kosovare
- Ofrim të shërbimeve me **kosto minimale në gjetjen e "businessleads"**.

Për t'u informuar më tepër rreth platformës, klikoni në linkun e mëposhtëm:

https://www.facebook.com/klubiprodhuesve.org/videos/2563416423981034/?t=0



Punëtoria “Made in Kosova”

KPK dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosova me 23 tetor, 2019, **inauguruan punëtorinë “Made in Kosova”**, qëllimi i së cilës është krijimi i një hapësire e cila mundëson **socializmin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rinjve për orientimin në karrierë**.

KPK në bashkëpunim me fondacionin ERTEV është angazhuar që përmes punëtorisë “Made in Kosova”, të ndihmojë fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe në rrezik të cilët përkrahen nga programet e SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë.

Punëtoria “Made in Kosova” përmban programe të cilat janë aktivitetet pas shkollore alternative për fëmijët dhe të rinjtë të moshës 8 deri 21 vjeç ku do të përfshihen:

- Klasa e drurit;
- Klasa metalike;
- Programim 3D dhe
- Klasa Origami.

Punëtoria gjendet në SOS Fshatrat e Fëmijëve në lagjen Velania, Prishtinë.

MEPPS

SKEMA E PLANIFIKIMIT DHE PROMOVIMIT TË EKSPORTIT PËR PRODHUESIT MEPPS (MANUFACTURING EXPORT PROMOTION PLAN SCHEME)

KPK në bashkëpunim me partnerëtka ndërtuar një ekip që është i **specializuar në tregtinë ndërkombëtare** (këshillim dhe shitje) që ka ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë për kompanitë që të **eksportojnë**. Ky ekip është përgjegjës për të punuar në tregjet si Amerika e Veriut dhe Bashkimi Europian (BE), rajoni i CEFTA-s përfshirë Turqinë dhe Lindjen e Mesme me Afrikën e Veriut.
KPK me platformën **“Made in Kosova”** dhe me rrjetin e tij të gjerë ndërkombëtar mund të luajë një rol të rëndësishëm në **mbështetjen e eksporteve** të Kosovës, duke promovuar kushtet në të cilat eksportet mund të rriten dhe ndihmojnë kompanitë për të identifikuar dhe ndjekin mundësi të reja.

Këtë vit, projekti MEPPS ka arritur që me sukses të:

- Ndihmoj 1 kompani në të gjitha fazat e saja të eksporteve duke filluar që nga matja e **gatishmërisë** për të eksportuar, **këshillimeve** për ndryshime të brendshme në kompani dhe po ashtu, ka arritur t’i siguroj kompanisë **partner të jashtëm për shitje** të produkteve të kompanisë;
- 3 kompani, përgjatë vitit 2019 kanë marrë **konsulencë** në lidhje me **shërbime të eksportit**. Dy kompani kanë përfunduar fazën e parë dhe njëra do të kaloj në fazën e dytë në fillim të vitit 2020;
- 6 kompani të cilat janë përzgjedhur që të ndihmohen (në fazat fillestare të eksportit ose ato të cilat tashmë eksportojnë), në **zgjerimin e tregjeve** të tyre nëpër vendet e tjera të BE-së, Amerikës, Afrikës dhe Lindjes së Mesme.

KOCME

QENDRA KOSOVARE PËR PËRSOSMËRI TË PRODHIMIT – KOCME (KOSOVAR CENTRE FOR MANUFACTURING EXCELLENCE)

KOCME të jetë një **qendër moderne**, e cila do të mbështesë krijimin e **vendeve të reja të punës** përmes **aftësimit profesional të të rinjve** që pritet t'i bashkohen tregut të punës, si dhe **avancimin e aftësive profesionale** të të rinjve të cilët janë në tregun e punës.

Qëllimi kryesor i KOCME do të jetë të bëjë **vitalizmin e aftësive të punëtorëve** përmes plotësimit të nevojave të kompanive dukë përfshirë praktikat më të mira globale në mësim nxënie në këto fusha:

- Zhvillimit dhe Trajnimit të Aftësive,
- Kërkimit dhe Dizajnit,
- Konkurrencës së Prodhimit.

KOCME do të ofrojë programe, të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin e profesioneve si:

- Teknolog të ushqimit,
- Përpunues të drurit,
- Përpunues të metalit,
- Përpunues të tekstilit,
- Punëtorë të mekatronikës dhe
- Punëtorë që do të aftësohen në përgatitje në kuzhina industriale (bukëpjekës, ëmbëlsira etj.).

Kjo qendër do të themelohet si **Fondacion** nga KPK dhe do të jetë nën menaxhimin e tij. Po ashtu, KOCME do të krijon partneritet me Universitete si dhe Institucione Ndërkombëtare , të cilët do të asistojnë në themelimin dhe menaxhimin e kësaj qendre.

KOCME do të luajë një rol të rëndësishëm në bërjen e Kosovës si **vend konkurrues për investime**, me fokus në tërheqjen e **investitorëve** me **potencial eksportues**.

Për të qenë të suksesshëm në ekonominë e sotme, kompanitë kosovare duhet të investojnë në punëtorët e tyre të ardhshëm por,edhe të rrisin aftësitë e punëtorëve ekzistues të tyre. Kështu sigurojnë që aftësitë shfrytëzohen në mënyrë efektive, por edhe kompanitë bëhen më konkurruese dhe sigurojnë cilësi të punës, produkte më cilësore dhe nxisin inovacionin.

Aktivitetet

KONFERENCAT, TRYEZAT E RRUMBULLAKËTA DHE PUNËTORITË

Gjatë vitit 2019 të zhvillimit të aktiviteteve të KPK-së, kanë qenë pjesë edhe organizimi i konferencave, tryezave dhe punëtorive për të trajtuar tema te rëndësishme për sektorin e prodhimit. Organizimi i aktiviteteve në formate te tilla ishte shumë frytdhënës, posaçërisht në:

Shkëmbimin e informatave për tema të caktuara dhe nxjerrjes së rekomandimeve të dobishme për ndryshimin e politikave dherregulloreve në fuqi – më qëllim mundësimin e mbarëvajtjes dhe zhvillimit të aktiviteteve prodhuese në vend.

KPK ka organizuar ngjarje me tema të ndryshme të ndërlidhura me sektorin e prodhimitduke filluar nga Energjia e Ripërtëritshme, Tregtia Rajonale, Shkathtësitë e fuqisë punëtore për nevojat e sektorit të prodhimit.

Punëtoria : Vazhdimësia e Biznesit (SuccessionPlanning)

Klubi i Prodhuesve të Kosovës së bashku me BERZH-in (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim), në kuadër të "Këshillat për Bizneset" ka organizuar punëtorinë me temën për Vazhdimësinë e Biznesit (SuccessionPlanning). Kjo punëtori pati për qëllim që të informoj mbi përgatitjet e ndërmarrjeve për transferin e menaxhmentit dhe pronësisë nga një gjeneratë tek tjera, duke implementuar një plan strategjik për transferim të tillë që nuk do të pengonte vazhdimësinë e aktiviteteve të biznesit. Prezantimi i punëtorisë u bë nga BorisVukic, partner dhe themelues i kompanisë AdizesSoutheastEurope (ASEE) që nga viti 1995 me përvojë në fushën e biznesit familjar, transformimit të biznesit si dhe ai është themelues i "Klubi 2040" për bizneset familjare.Ndërsa një rast studimor u prezantua nga StipeBorovac, djali i themeluesit të Borovacd.o.o, kurse tani në rolin e drejtorit ekzekutiv i cili ndau përvojën e tij.

E ardhmja dhe sfidat e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë

Klubi i Prodhuesve të Kosovës së bashku me Odën Ekonomike të Kosovës gjatë muajit Maj ka organizuar konferencën "E ardhmja dhe sfidat e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë" e cila ka adresuar temat të cilat ndikojnë në të ardhmen e energjisë së ripëtëritshme dhe zhvillimin e këtij sektori. Gjatë konferencës u diskutua për tarifat nxitëse, si një ndër stimujt kryesorë të investimit në prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Po ashtu, u shqyrtua edhe korniza ekzistuese rregullative për promovimin e projekteve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në Kosovë, mënyrat e financimit të këtij sektori dhe se ku qëndron rëndësia e financimit të këtij sektori nga institucionet financiare në Kosovë.

Mundësitë dhe sfidat e marrëdhënieve tregtare Kosovë-Shqipëri

Klubi i Prodhuesve të Kosovës së bashku me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë, Odën Ekonomike të Kosovës, Odën Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore dhe Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë organizuan konferencën e përbashkët "Mundësitë dhe sfidat e marrëdhënieve tregtare Kosovë-Shqipëri", e cila u mbajt në kuadër të Forumit Ekonomik Mbarë-Shqiptarë.Kjo konferencë kishte për qëllim prezantimin dhe adresimin e sfidave dhe barrierave tregtare që prodhuesit e Kosovës dhe Shqipërisë po hasin gjatë tregtimit të produkteve të tyre në këto dy tregje, por edhe mundësitë dhe lehtësimet që i ju janë ofruar nga të dy qeveritë përkatëse.Të pranishëm në konferencë ishin përfaqësues të bizneseve nga të dy vendet por edhe përfaqësues nga të dy qeveritë si Ministrja e Financave dhe Ekonomisë së Shqipërisë- Anila Denaj, EduardShalsi – Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në Shqipëri, Endrit Shala- Ministër i Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Kosovës.



VIZITAT E PUNËS JASHTË VENDIT

Takimi me Ambasadorin e Kosovës në Kroaci

Klubi i Prodhuesve të Kosovës është takuar me ambasadorin e Republikës së Kosovës në Kroaci, z.GezimKasapolli, me të cilin biseduan për sfidat të cilat prodhuesit i hasin gjatë eksportit të produkteve të tyre. Gjatë takimit z. Kasapolli, vlerësoi punën e prodhuesve dhe ju ofrojë gatishmërinë për bashkëpunim në të ardhmen. Po ashtu gjatë takimit përfaqësuesit e Klubit të Prodhuesve dhe ambasadori Kasapolli shkëmbyen mendime lidhur me zhvillimet më të fundit në Kroaci dhe Kosovë, si dhe për gjetjen e rrugëve të reja për të nxitur bashkëpunimin e mëtejshëm ekonomik në mes të këtyre dy vendeve.

Takimi në Konsullatën e Kosovës në NewYork

Gjatë një vizite në NewYork, drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve, Astrit Panxha u takua me konsullën e Përgjithshme së Kosovës në Nju Jork, znj. Teuta Sahatqija. Takimi ishte mundësi e mirë për shqyrtimin e mundësive të rritjes e eksportit të produkteve kosovare dhe mundësitë e tjera të bashkëpunimit. Gjatë takimit u diskutua për promovimin e produkteve Made in Kosova edhe në tregun e Amerikës. Konsulta u njoftua nga afër me punën e deritanishme të këtij brendi, por edhe me misionin dhe vizionin e Klubit të Prodhuesve.

PJESËMARRJA NË KONFERENCAT RAJONALE

AUSTRIA CONNECT Evropa Juglindore 4.0

Klubi i Prodhuesve së bashku me zyrën Advantage Austria ishin pjesëmarrës në konferencën rajonale Austria ConnectSoutheastEurope 4.0, ku tema kryesore ishte dixhitalizimi në prodhim. U diskutua se si ndikon transformimi dixhital në sektorin e prodhimit dhe në atë të shërbimeve, por edhe cilat kompetenca u duhen menaxherëve për një transformim të suksesshëm dixhital në ekonomi dhe shoqëri. Gjithashtu edhe cilat modele të biznesit do të çojnë kompanitë drejt suksesit në të ardhmen.Austria Connect e Evropës Juglindore – është konferenca më e rëndësishme profesionale austriake në rajon, e cila fillimisht u organizua në Zagreb dhe Beograd. Edicioni i tretë i kësaj konference u organizua me shkollën e Biznesit Bled, një nga institucionet arsimore më prestigjioze për zhvillimin e udhëheqjes në rajon.

Kongresi i dytë Ekonomik të Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane

Klubi i Prodhuesve të Kosovës ishte pjesëmarrës në Kongresin e dytë Ekonomik të Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane i cili u mbajt në nëntor 2019 në Frankfurt të Gjermanisë, ku morën pjesë mbi 600 firma të fuqishme shqiptare dhe gjermane.Në kuadër të këtij forumi ekonomik, po ashtu u mbajt edhe një panair me qëllim që të ju krijohet hapësirë prodhuesve kosovarë për tregun e Evropës dhe të Gjermanisë. Kongresi ishte një mundësi e mirë për krejt prodhuesit kosovar që synojnë tregun evropian. Klubi i Prodhuesve në kuadër të kongresit të dytë ekonomik të Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane u bë edhe prezantimi i punës dhe aktiviteteve të Klubit të Prodhuesve të Kosovës. Në panelin e diskutimit, ku i ftuar ishte edhe drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve, Astrit Panxha ndër të tjerash u diskutua edhe për krijimin e mundësive për eksport dhe investime kapitale në Kosovë.

Konventën e Parë të Prodhuesve Shqiptarë

Klubi i Prodhuesve morri pjesë edhe në Konventën e Parë të Prodhuesve Shqiptarë, organizuar nga Bashkimi i Prodhueseve Shqiptarë, qëllimi i së cilës ishte promovimi i mëtejshëm i prodhimit dhe diskutimi mbi sfidat që e përcjellin këtë sektor. Drejtori ekzekutiv i Klubit, Astrit Panxha foli për barrierat tregtare që produktet e Kosovës po hasin në tregun e Shqipërisë, por edhe për fuqizimin e marrëdhënieve ekonomike në mes të dy vendeve.

MËNGJESET DHE DREKAT EKZEKUTIVE

KPK e ndjek praktikën e organizimit tëaktiviteteve të tilla,të cilat ofrojnë një platformë të nivelit të lartë për ndikimin dhe rrjetëzimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme me të cilat përballen anëtarët tanë, dhe prodhuesit në Kosovë në përgjithësi.Në pjesën e tretë të vitit 2019, Klubi organizoi **mëngjes ekzekutiv** me Drejtorin e Doganave te Kosovës.

MIRËNJOHJET PËR PUNËN E KLUBIT

Klubit të Prodhuesve të Kosovësiu është ndarë çmimi **“Mik i fëmijëve“** nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, për kontributin e çmuar në shërbime sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë.Klubi i Prodhuesve është shpërblyer me këtë çmim për angazhimin dhe kontributin për mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve përmes projekteve që i ka ndërmarrë në bashkëpunim me SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë.

PËRKUJTIM

Klubi i Prodhuesve të Kosovës gjatë vitit 2019 humbi anëtarin dhe një ndër themeluesit e parë të Klubit, **z.Astrit Shabani**. Ai ndërroi jetë pas një sëmundje të rëndë, duke na lënë që ta kujtojmë gjithmonë si një njeri punëtor dhe me plotë dashuri për njerëzit. Gjatë mbledhjes komemorative shumë kolegë dhe bashkëpunëtorë të tij e kujtuan atë me fjalët më të mira për personalitetin dhe punën e tij.Ai do të kujtohet gjithmonë si një njeri që ka kontribuar shumë për promovimin dhe ngritjen e prodhimeve të Kosovës. Komunitetit të biznesit do të i mungojë një emër i shquar, i cili ia kushtoi gjithë jetën punës dhe zhvillimit ekonomik.

Do ta kujtojmë gjithmonë dhe përherë do të mbetet në zemrat tona!

U prehsh në paqe Astrit Shabani!

Ekipi i Klubit të Prodhuesve të Kosovës

Astrit Panxha
Drejtor Ekzekutiv

Tanita Zhubi
Menaxhere për PR & Komunikim

Vllaznim Osmani
Sekretar Gjeneral

Besart Zhuja
Analist i Politikave

Ylberina Hysaj Arifi
Koordinatore e Zyrës

Vesa Shehu Hoxha
Koordinatore e Projekteve

> Ne veprojmë me përkushtim në implementim të strategjisë, realizim të aktiviteteve dhe qëllimeve të Klubit - për të ndihmuar anëtarët tonë të zhvillohen dhe rriten.